

**Deri te:  
Këshilli Mësimor-Shkencor  
i Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore  
të Universitetit të Tetovës**

**R E F E R A T**

Për zgjedhjen e mësimdhënësit në thirrjen Docent në fushën e kimisë në FSHMN pranë Universitetit të Tetovës

Këshilli mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, pranë Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 07.12.2020, solli Vendim me nr. 15-2031/1 për formimin e komisionit recensues për zgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen mësimore-shkencore për lëndët mësimore në fushën e kimisë.

Komisioni recensues në përbërje:

1. Prof.Dr. Agim Shabani, profesor ordinar, Programi studimor i Kimisë – FSHMN, Universiteti i Tetovës – kryetar;
2. Prof.Dr. Shefket Dehari, profesor inordinar, Programi studimor i Kimisë – FSHMN, Universiteti i Tetovës – anëtar; dhe
3. Doc.Dr. Zulfhevat Abdija, docent, Programi studimor i Kimisë – FSHMN, Universiteti i Tetovës – anëtar,

pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranuar ka nderin që në vijim të paraqet deri te Këshilli Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, pranë Universitetit të Tetovës këtë

**R A P O R T**

Në konkursin e shpallur në gazetën “Koha” dhe “Sloboden pečat”, si dhe në faqen e UT-së [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), më 28.11.2020 për zgjedhjen e mësimdhënësit në thirrjen mësimore-shkencore Docent për lëndët mësimore në fushën e kimisë, në Programin Studimor të Kimisë, janë paraqitur dy kandidatë, Dr. sc. Agron Alili dhe Dr. Sc. Faik Alili.

## **Të dhëna biografike të kandidatit Dr. Sc. Agron Alili,**

Dr. Sc. Agron Alili është e lindur më 31.01.1973 në Gostivar, komuna e Gostivarit, Republika e Maqedonisë së Veriut. Shkollën fillore dhe të mesme e ka kryer në Gostivar. Është regjistruar në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, dega e Kimisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Studimet i përfundon në vitin 1998. Në vitin 1998 mbron temën e diplomës me titull **“Benzamidometilimi i acidit nikotimik”** në mentorim të Prof. Dr. Liljana Klisarova dhe fiton titullin profesor i kimisë. Në vitin akademik 2010/11 regjistron studimet postdiplomike në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, në Departamentin e Kimisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe në 02.12.2011 mbron temën e magjistraturës me titull **“Sinteza e disa N,N – Benzamidometil derivateve të reja të toluensulfonamidit në mënyra të ndryshme sintetike”** nën mentorim të Prof. Dr. Emil Poposki dhe fiton titullin magjistër i shkencave të kimisë. Në vitin 2019, në Fakultetin e Shkencave natyrore dhe teknike pranë Universitetit “Goce Delcev” në Shtip mbron me sukses disertacionin e doktoratës me titull **“Aspektet ekologjike dhe socio-ekonomike mbi menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme në nivel lokal”** nën mentorim të Prof. Dr. Boris Krstev dhe merr titullin **Doktor i Shkencave tekniko-teknologjike, ambienti jetësor**. Disertacioni i doktoratës ka dhënë kontribut të veçantë shkencor për zhvillim të strategjisë rreth menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme me theks të veçantë për mbetjet medicinale në nivel lokal. Rezultatet e punimit të doktoratës janë publikuar në konferenca, në revista me impakt faktor, në manifestime të ndryshme shkencore në vend dhe jashtë vendit.

Kandidati ka qenë i punësuar në vitin 1998 në QAMO “Zllate Mallakoski” në Gostivar si profesor i kimisë ku qëndron deri në vitin 2001. Nga viti 2001 punësohet në Gjimnazin e Gostivarit si profesor i kimisë dhe në vitin 2003 emërohet drejtor i Gjimnazit të Gostivarit, të cilën detyrë e kryen deri në vitin 2009. Nga viti 2009 deri në vitin 2013 punon si profesori i kimisë në Gjimnaz, ndërsa në vitin 2014 kalon në shkollën e mesme të mjekësisë të Gostivarit ku caktohet drejtor shkolle dhe këtë detyrë e kryen deri në vitin 2018. Në vitin 2019 punësohet si Këshilltarë për arsim të përgjithshëm dhe profesional pranë Universitetit Civil më Mësim të përjetshëm në Gostivar.

Në vitin akademik 2012/2013 është angazhuar (part-time) në Universitetin e Tetovës si bashkëpunëtorë dhe mësues në programet studimor-Teknologjia ushqimore dhe programin studimor - Te ushqyerit pranë FTUU në UT. Në këta programe studimore ka mbajtur ushtrimet në këto lëndë: Kimi e përgjithshme dhe Kimi organike. Në vitin akademik 2019/20 ka mbajtur ligjërata në programin studimor Fizik-Kimi në lëndën: Kimi e përgjithshme II, ndërsa në vitin akademik 2020/2021 është angazhuar si mësues në programin studimor- Menaxhimi me cilësinë e ushqimit ne FTUU pranë UT-se në lëndën e Kimiku është ligjërues edhe aktualisht.

### **Veprimtaria mësimore-arsimore**

#### **Mbajtja e mësimit (ushtrime dhe ligjërata)**

Kandidati Dr. Sc. Agron Alili ka mbajtur mësim (ligjërata, nën mentorim) në lëndët në vijim:

- Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit – programi studimor Të Ushqyerit- **Kimi organike,**
- Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit – programi studimor Teknologji Ushqimore, - **Kimi organike,**
- Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore - programi studimor Fizikë-Kimi
  - **Kimia e përgjithshme II**
  - Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit – programi studimor Menaxhimi me cilësinë e ushqimit,**Kimi**

dhe mësim (ushtrime) në këto lëndë:

- ❖ Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit – programi studimor Të Ushqyerit - **Kimi e përgjithshme, Kimi organike**
- ❖ Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit – programi studimor Teknologji Ushqimore-**Kimi e përgjithshme, Kimi organike**

Kandidati ka marrë pjesë në punëtori, trajnime, projekte dhe konferenca .

- Pjesëmarrje aktive dhe mentorim të 9 nxënësve në projekt ndërkombëtar me titull “The care and knowledge alliance ”, Madrid, Spanje 2015;
- Pjesëmarrës në trajnim ndërkombëtarë Erasmus+ project management for teachers and school management –Module 1,përkrahur nga Komisioni Europian, Barcelonë, Spanjë 2017;
- Pjesëmarrës përmes (Qendrës Ndërkombëtare për zhvillim , edukim dhe trajnim me seli në Sofje) në projekt ndërkombëtar“Project for professional development of medical and dental students from Gostivar ”përkrahur nga Komisioni Europian , Sofje, Republika e Bullgarisë, 2018;
- Pjesëmarrës në punëtorinë e parë ndërkombëtare në kuadër të projektit“Enchanting New Age Skills for Adults ”përkrahur nga Agjensioni Nacional për programe arsimore dhe mobilitet, Strugë, 2019;
- Pjesëmarrës në punëtorinë e dytë ndërkombëtare në kuadër të projektit“Enchanting New Age Skills for Adults ” përkrahur nga Agjensioni Nacional për programe arsimore dhe mobilitet, Barcelos, Portugali, 2019;
- Pjesëmarrës nëpunëtorinë e tretë ndërkombëtare në kuadër të projektit“Enchanting New Age Skills for Adults ” përkrahur nga Agjensioni Nacional për programe arsimore dhe mobilitet, Madrid, Spanje 2019.

### **Veprimtaria shkencore-hulumtuese**

Krahas angazhimit në procesin mësimor, Dr. Sc. Agron Alili është angazhuar vazhdimisht në hulumtime shkencore në fushën e kimisë dhe fushën e ambientit jetësor. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet nga artikujt shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare dhe me pjesëmarrje në punëtori dhe konferenca shkencore ndërkombëtare. Kjo veprimtari e kandidatit është paraqitur më poshtë:

## A. Artikuj shkencorë

- **Agron Alili**, Antonio Buzharovski, Jasmina Tanatarec, Bozhana Mikhova, Gerald Draeger, Kristina Mladenovska, Emil Popovski, *SYNTHESIS OF NEW N - BENZAMIDOMETHYL DERIVATIVES OF TOLUENESULFONAMIDE BY DIFFERENT SYNTHETIC ROUTES*, Oher, 2010.
- **Agron Alili** et al. (2015) *The performance with data processing of chemical treatment with leaching and bio-leaching.* In: XIII National conference with international participation of the open and underwater mining of minerals, 01-05 Sept 2015, Varna, Bulgaria.
- **Alili Agron** et al. (2015) *The hazardous medical waste – treatment technologies, location and origin.* *Natural Resources and Technologies*, 9 (9). pp. 279-284. ISSN 185-6966
- **Alili Agron** et al. (2015) *Disposed biomass as a new origin for heat power – possibilities and perspectives.* *Natural Resources and Technologies*, 9 (9). pp. 233-244. ISSN 185-6966,
- **Alili Agron** et al. (2019) *Effective Teams for Sustainable Projects– Principles, Practice and Presentation.* In: ITRO 2019, Zrenjanin, Republic of Serbia.
- **Alili Agron** et al. (2014) *Analysis of the current state of waste batteries in R. Macedonia.* In: Подекс – Повекс “14, 14-15 Nov 2014, Radovis, Macedonia.
- **Alili Agron** et al. (2014) *POPs as hazardous waste and appearance in the industry.* In: Подекс – Повекс “14, 14-15 Nov 2014, Radovis, Macedonia.
- **Alili Agron** (2019) *Development strategy for development and appropriate treatment of hazardous waste at the local level,* *International Journal Knowledge*, ISSN 2545-4439, Vol. 32.3, pp. 379-383
- **Alili Agron** (2019) *Using SPSS for research and data analysis* *International Journal Knowledge*, ISSN 2545-4439, Vol. 32.3, pp. 363-369.

## **B.Tubime shkencore (konferenca/simpoziume/kongrese)**

- ✓ Pjesëmarrës në Kongresin e XXI Ndërkombëtar të Kimistëve dhe Teknologëve në RMV të mbajtur në Ohër në vitin 2010 ku kandidati ka pasur prezantim posterial në temën:SYNTHESIS OF NEW N - BENZAMIDOMETHYL DERIVATIVES OF TOLUENESULFONAMIDE BY DIFFERENT SYNTHETIC ROUTES;
- ✓ Pjesëmarrës në Këshillimin e VII profesional Ndërkombëtar të Xehtarëve dhe Gjeologëve në RMV të mbajtur në Radovish në vitin 2014 në temën: ANALYSIS OF THE CURRENT STATE OF WASTE BATTERIES IN R. MACEDONIA;
- ✓ Pjesëmarrës në Konferencën e XIII Ndërkombëtare për shfrytëzimin e mineraleve në temë:The performance with data processing of chemical treatment with leaching and bio-leaching, Varna , Republika e Bullgarise , 2015;
- ✓ Pjesëmarrës në konferencën EKVET ( European Credit system for Vocational Education & Training ) , 2017, Shkup;
- ✓ Qëndrim studimor në Fakultetin e Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit (FMTHM) ne kuadër te Universitetit "Haxhi Zeka" , Pejë, Republika e Kosovës, 2017;

Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni recensues e konstatoi veprimtarinë shkencore-hulumtuese në periudhën paraprake, e cila është me rëndësi thelbësore për vlerësimin e kandidatit.

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, kandidati Dr.Sc. Agron Alili ka realizuar gjithsej 24.00 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.

### **Veprimtaria profesionale-aplikative**

#### **Pjesëmarrje në aktivitete promotive të fakultetit**

Kandidati, Dr. Sc. Agron Alili ka marrë pjesë në aktivitetet promotive “USHT – Ditët e hapura në vitet 2012 dhe 2013 ne promovimin e programit studimor -Teknologji ushqimore dhe programi studimor -Te ushqyerit , pranë Fakultetit tëTeknologjisëushqimore dhe të ushqyerit në UT.

### **Veprimtaria me interes më të gjërë**

Kandidati Dr. Sc. Agron Alili si doktorant në vitin 2017 realizon qëndrim studimor në Fakultetin e Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit (FMTHM) në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka" të Pejës në periudhën kohore 01.06.2017 deri 15.08.2017 vit, ku ka kryer hulumtime shkencore në funksion të punimit të doktoratës dhe interesit më të gjërë.

### **Formulari për raportin për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore**

Si shtojcë e referatit është bashkangjitur raporti i zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Dr. Sc. Agron Alili ka gjithsej 61.77 pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore – 18.77 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese – 24.00 pikë, veprimtarinë profesionale-aplikative – 8.00 pikë, veprimtaritë me interes më të gjërë – 9.00 pikë dhe për veprimtari sportive 2.00 pikë.

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>18.77</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>24.00</b>
<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE</b>	<b>8.00</b>
<b>VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË</b>	<b>9.00</b>
<b>VEPRIMTARITË SPORTIVE</b>	<b>2.00</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>61.77</b>

### **Të dhëna biografike të kandidatit Dr. Sc. Faik Alili,**

Dr. Sc. Faik Alili është e lindur më 01.11.1959 në fshatin Vërbjan, komuna e Gostivarit, Republika e Maqedonisë së Veriut. Shkollën fillore dhe të mesme e ka kryer në Gostivar. Në vitin 1979 është regjistruar në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, dega e Kimisë pranë Universitetit të Prishtinës. Studimet i përfundon në vitin 1984 dhe ka fituar titullin Profesor i kimisë. Në vitin 2007 është në ciklin e dytë në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, dega e Kimisë pranë Universitetit të Prishtinës. Studimet e ciklit të dytë i përfundon në vitin 2009 dhe ka fituar gradën Master i shkencave të kimisë. Studimet e ciklit të tretë i ka regjistruar në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, dega e Kimisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” Shkup. Temën e doktoraturës me titull “Modele të orëve mësimore të kimisë me zbatim të qasjeve konstruktive të nxënies” e mbron me sukses me datë 29.10.2017 dhe fiton titullin shkencor Doktor i shkencave të kimisë.

#### **ÇERTIFIKATA:**

2001- 2001 FMN-Shkup

Zbatimi i kompjuterëve për mësim në kontinuitet nga kimia (PROJEKTI TEMPUS)

2001- 2003 Pesë seminare nga projekti Arsimim dhe mësim kreativ,

Metoda për mësim me lexim dhe shkrim deri te të mësuarit kreativ (USAID ME Fondacionin Soros)

2004- Kryqi i kuq i Maqedonisë,

Koordinator i projektit KRYQI I KUQ NË AKSION-PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE

2002-2008 Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut-Qendra për zgjedhjen e konflikteve,

Koordinator i projektit për gjimnazin e Gostivarit

02/06 2006 Universiteti i Europës Juglindore-Tetovë,

Programi për drejtor të shkollave te mesme

Përkthyes i librit KIMIA FIZIKE, për Arsimin e lartë,



Përkthyes i librit Kimia Analitike, për nxënësit e vitit të dytë të Shkollave të mesme

### **PERVOJË PUNE:**

1984-1999. Profesor i kimisë, Gjimnazi Pance Poposki, Gostivar dhe në shkolla fillore

38 vjet pervojë pune në arsim, si profesor i kimisë për edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja.

1999-2003 Drejtor i SHME Çede Filiposki-Gostivar

2003-deri më sot. Profesor i kimisë në Gjimnazin e Gostivarit.

### **PUNIME TË BOTUARA:**

1. Faik Alili, Sllobotka Aleksovska, A MODEL OF A LESSON FOR GENERALIZATION THE KNOWLEDGE ON CLASSES OF INORGANIC COMPOUNDS WITH CONSTRUCTIVIST APPROACH AND COMPARISON WITH THE TRADITIONAL ONE, Asian Academic Research Journal of Multidisciplinary(AARJMD), 4(2), 2017.

2. Faik Alili, Sllobotka Aleksovska, EFFECTIVENESS OF THE CASE-BASED TEACHING APPROACH IN LEARNING CHEMISTRY, Journal of Natural Sciences and Matematich of UT, 2(3), pp. 127-136, Tetove, 2017.

3. Azis BEHRAMI, Marigona ÇOLLAKU, Arber HYSENI, Faik ALILI, Fatos REXHEPI\*, ROSEMARY EXTRACT CAN BE USED AS A NATURAL PROTECTIVE AGENT DECOMPOSITION OF FREE FATTY ACIDS, European Journal of Materials Science and Engineering, Volume 5, Issue 1; 2020: 32-36, www.ejmse.tuiasi.ro, ISSN:2537-4338

### **Pjesëmarrje në Konferenca**

1. Faik Alili, Sllobotka Aleksovska, CONSTRUCTIVIST TEACHING/LEARNING APPROACH FOR IRONING-OUT MISCONCEPTIONS RELATED TO STRUCTURE AND NOMENCLATURE OF ALICYCLIC AND AROMATIC COMPOUNDS, International Scientific Conference "CONTEMPORARY PERSPECTIVES OF EDUCATIONAL WORK", Preshevë, 2018.

### **Formulari për raportin për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore**

Si shtojcë e referatit është bashkangjitur raporti i zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Dr. Sc. Faik Alili ka gjithsej 45.60 pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore – 26.00 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese – 12.60 pikë, veprimtarinë profesionale-aplikative – 3.00 pikë, dhe veprimtaritë me interes më të gjerë – 4.00 pikë

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>26.00</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>12.60</b>
<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE</b>	<b>3.00</b>
<b>VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË</b>	<b>4.00</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>45.60</b>

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë të aktiviteteve në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarive me interes më të gjerë, Komisioni konstaton se nga dy kandidatët e paraqitur në konkurs Dr. Sc. Agron Alili dhe Dr. Sc. Faik Alili, kandidati Dr.sc. Agron Alili ka qenë i angazhuar në FSHMN–dega e Kimisë part-time, ku ka mbajtur ligjërata dhe ushtrime, po ashtu ka më tepër punime shkencore të botuara, për këtë arsye Kandidati Dr. Sc. Agron Alili ka përparësi ndaj kandidatit Dr. Sc. Faik Alili dhe në përputhje me Ligjin për arsim sipëror dhe Statutin e UT-së, si dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, dhe mësimore-profesionale në Universitetin e Tetovës, kandidati Dr. Sc. Agron Alili i plotëson të gjitha kriteret për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **Docent**.

Duke pasur parasysh atë që u paraqit më lartë, Komisioni recensues i propozon Këshillit mësimor-shkencor të Fakulteti të Shkencave Matematike-Natyrore, pranë Universitetit të Tetovës, që kandidati **Dr.sc. Agron Alili** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** për lëndët mësimore në fushën e kimisë, në Programin Studimor të Kimisë.

Tetovë, 11.12.2020

### KOMISIONI RECENSUES

1. **Prof. Dr. Agim Shabani**, profesor ordinar në Programin Studimor të Kimisë – FSHMN, pranë Universitetit të Tetovës – kryetar

---

2. **Prof. Dr. Shefket Dehari**, profesor inordinar në Programin Studimor të Kimisë – FSHMN, pranë Universitetit të Tetovës – anëtar

---

3. **Doc. Dr. Zulxhevat Abdija**, docent në Programin Studimor të Kimisë – FSHMN, pranë Universitetit të Tetovës – anëtar

---

## S H T O J C Ë

### PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

**Kandidati:** Agron Azbi Alili

**Institucioni:** Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore – UT, Tetovë

**Lëmia shkencore:** Kimi

#### I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
	<b>Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e parë)</b>	
<b>1</b>	Kimia e organike (Teknologji ushqimore) (3+3), 1 semestër	$3 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.8$
	Kimia organike (Te ushqyerit) (3+3), 1 semestër	$3 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.8$
	Kimia e përgjithshme II (Fizik-Kimi) (3+3), 1 semestër	$3 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.8$
	Kimi (Menaxhimi me cilësinë e ushqimit-FTUU) (4+4), 1 semestër	$4 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 2.4$
	<b>Konsultime me studentë</b>	
<b>2</b>	Kimia organike (Teknologji ushqimore) (3+3), 1 semestër, 20 student	$20 \times 1 \times 0.002 = 0.04$
	Kimia organike (Të ushqyerit) (3+3), 1 semestër, 5 student	$5 \times 1 \times 0.002 = 0.01$
	Kimia e përgjithshme II (Fizik-Kimi) (3+3), 1 semestër, 6 student	$6 \times 1 \times 0.002 = 0.01$
	Kimi (Menaxhimi me cilësinë e ushqimit-FTUU) (4+3), 1 semestër, 5 student	$5 \times 1 \times 0.002 = 0.01$
<b>3</b>	<b>Mbajtja e ushtrimeve (në ciklin e parë)</b>	
	Kimia organike (Teknologji ushqimore) (3+3), 1 semestër	$3 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 1.35$
	Kimia organike (Te ushqyerit) (3+3), 1 semestër	$3 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 1.35$
	Kimi e përgjithshme (Teknologji ushqimore) (3+3), 1 semestër	$3 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 1.35$
	Kimi e përgjithshme (Te ushqyerit) (3+3), 1 semestër	$3 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 1.35$
	<b>Mësimi në shkollë dhe punëtori</b>	
<b>4</b>	<b>Udhëheqës i seminarit</b>	
	Udhëheqës i 9 nxënësve të shkolles medicinale në seminar ndërkombëtar me titull "The care and knowledge alliance", Madrid, Spanjë 2015	<b>1.5</b>
<b>5</b>	<b>Pjesëmarrës në punëtori</b>	
	Pjesëmarrës në punëtorinë e parëndërkombëtare në kuadër të projektit "Enchanting New Age Skills for Adults" përkrahur nga Agjensioni Nacional për programe arsimore dhe mobilitet, Strugë, 2019	<b>1</b>
	Pjesëmarrës në punëtorinë e dytë ndërkombëtare në kuadër të projektit "Enchanting New Age Skills for Adults" përkrahur nga Agjensioni	<b>1</b>

	Nacional per programe arsimore dhe mobilitet, Barcelos, Portugali, 2019	
	Pjesmarrës në puntorinë e tretë ndërkombetare në kuadër të proektit “Enchanting New Age Skills for Adults ” përkrahur nga Agjensioni Nacional për programe arsimore dhe mobilitet, Madrid, Spanje 2019	<b>1</b>
	Pjesmarrës në puntorinë nderkombetare Erazmus+ project management for teachers and school menagment –Module 1, përkrahur nga Komisioni Europian, Barcelonë, Spanjë 2017	<b>1</b>
	<b>Gjithsej:</b>	<b>18.77</b>

## II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar dhe impact factor</b>	
<b>1</b>	Agron Alili et all. (2015) <i>The performance with data processing of chemical treatment with leaching and bio-leaching</i> . In: XIII National conference with international participati on of the open and underwater mining of minerals, 01-05 Sept 2015, Varna, Bulgaria.	<b>3,6</b>
<b>2</b>	Alili Agron et all. (2015) <i>The hazardous medical waste – treatment technologies, location and origin</i> . Natural Resources and Technologies, 9 (9). pp. 279-284. ISSN 185-6966	<b>2,4</b>
<b>3</b>	Alili Agron et all.(2015) <i>Disposed biomass as a new origin for heat power – possibilities and perspectives</i> . Natural Resources and Technologies, 9 (9). pp. 233-244. ISSN 185-6966,	<b>2,4</b>
<b>4</b>	Alili Agron et al. (2019) <i>Effective Teams for Sustainable Projects– Principles, Practice and Presentation</i> . In: ITRO 2019, Zrenjanin, Republic of Serbia.	<b>3,6</b>
<b>5</b>	Alili Agron (2019) <i>Development strategy for development and appropriate treatment of hazardous waste at the local level</i> , International Journal Knowledge, ISSN 2545-4439, Vol. 32.3, pp. 379-383	<b>6</b>
<b>6</b>	Alili Agron (2019) <i>Using SPSS for research and data analysis</i> International Journal Knowledge, ISSN 2545-4439, Vol. 32.3, pp. 363-369.	<b>6</b>
	<b>Gjithsej:</b>	<b>24.0</b>

## III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
	<b>Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare</b>	

2	Pjesmares ne konferencen EKVET ( European Credit system for Vocational Education & Training ) , 2017, Shkup;	1
3	Pjesmarrës përmes (Qendres Nderkombetare për zhvillim , edukim dhe trajnim me seli në Sofje) në projekt ndërkombëtar "Project for professional development of medical and dental students from Gostivar " perkrahur nga Komisioni Europian , Sofje, Republika e Bullgarisë, 2018	1
4	Kordinator i projektit ndërkombëtar Erasmus + "Project for professional development of medical and dental students from Gostivar ", ANPAM-Shkup,2017;	2
5	Kordinator i projektit ndërkombëtar Erasmus+ "IMAGINE ", Agjensioni Nacional per programe arsimore dhe mobilitet, Shkup,2018	2
6	Kordinator i projektit ndërkombëtar Erasmus + "Enchanting New Age Skill for Adults " , ANPAM-Shkup,2018-2019;	2
	Gjithsej:	8

#### IV. VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
1	Udheheqes i arsimit fillore dhe te mesemprofesional per te rriturit ne Univerzitetin Civil me Mesim te Perjetshem "Gostivar"-Gostivar, 2017/18	3
2	Qëndrim dy mujor studimor në Fakultetin e Menaxhimit të Turizmit, Hotelierisë dhe Mjedisit (FMTHM) në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka" , Pejë, Republika e Kosovës, 2017;	1
3	Pjesëmarrje në komisione dhe trupa tjerë organesh shtetërore	1
4	Drejtor në Gjimnazin e Gostivarit për periudhë 2003-2009 dhe shkollën e mesme medicinale të Gostivarit , 2004-2019(gjithsej 12 vjet)	4
	<b>Gjithsej :</b>	<b>9</b>

#### V. VEPRIMTARITËSPORTIVE

1	Kryetar i shoqates së klubit sportiv shkollor MADIKAL14 ne Shkollën e mesme Medicinale të Gostivarit , viti 2017.	2
	<b>Gjithsej :</b>	<b>2</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>18.77</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>24.00</b>
<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE</b>	<b>8.00</b>
<b>VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË</b>	<b>9.00</b>
<b>VEPRIMTARITË SPORTIVE</b>	<b>2.00</b>

## S H T O J C Ë

PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE,  
SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE**Kandidati:**Faik Rizvan Alili**Institucioni:** Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore – UT, Tetovë**Lëmia shkencore:**Kimi

## I VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
1	Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e parë)	
2	Konsultime me studentë	
3	Mbajtja e ushtrimeve (në ciklin e parë)	
	Mësimi në shkolla dhe punëtori	
	Profesor në shkollë të mesme	4
4	Pjesëmarrës në punëtori	
	Zbatimi i kompjuterëve për mësim në kontinuitet nga kimia (PROJEKTI TEMPUS)	1
	Metoda për mësim me lexim dhe shkrim deri te të mesuarit kreativ (USAID ME Fondacionin Soros)	1
	Përkthim të librave	
5	Përkthyes i librit KIMIA FIZIKE, për Arsimin e lartë,	10
6	Përkthyes i librit Kimia Analitike, për nxënësit e vitit të dytë të Shkollave të mesme	10
	<b>Gjithsej:</b>	26

## II VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar dhe impact factor	

1	Faik Alili, Sillobotka Aleksovaska, A MODEL OF A LESSON FOR GENERALIZATION THE KNOWLEDGE ON CLASSES OF INORGANIC COMPOUNDS WITH CONSTRUCTIVIST APPROACH AND COMPARISON WITH THE TRADITIONAL ONE, Asian Academic Research Journal of Multidisciplinary(AARJMD), 4(2), 2017.	5.4
2	Faik Alili, Sillobotka Aleksovaska, EFFECTIVENESS OF THE CASE-BASED TEACHING APPROACH IN LEARNING CHEMISTRY, Journal of Natural Sciences and Matematich of UT, 2(3), pp. 127-136, Tetove, 2017.	1.8
3	Azis BEHRAMI, Marigona ÇOLLAKU, Arber HYSENI, Faik ALILI, Fatos REXHEPI, ROSEMARY EXTRACT CAN BE USED AS A NATURAL PROTECTIVE AGENT DECOMPOSITION OF FREE FATTY ACIDS, European Journal of Materials Science and Engineering, Volume 5, Issue 1; 2020: 32-36,	3.6
4	Faik Alili, Sillobotka Aleksovaska, CONSTRUCTIVIST TEACHING/LEARNING APPROACH FOR IRONING-OUT MISCONCEPTIONS RELATED TO STRUCTURE AND NOMENCLATURE OF ALICYCLIC AND AROMATIC COMPOUNDS, International Scientific Conference "CONTEMPORARY PERSPECTIVES OF EDUCATIONAL WORK", Preshevë, 2018.	1.8
	<b>Gjithsej:</b>	<b>12.6</b>

### III VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
	<b>Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare</b>	
1	Koordinator i projektit KRYQI I KUQ NË AKSION-PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE	1.5
2	Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut-Qendra për zgjedhjen e konflikteve, Koordinator i projektit për gjimnazin e Gostivarit	1.5
	<b>Gjithsej:</b>	<b>3</b>

### IV VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
1	Drejtor në Shkollën e mesme ekonomike Çedo Filiposki	4
	<b>Gjithsej :</b>	<b>4</b>



<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>26.00</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>12.60</b>
<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE</b>	<b>3.00</b>
<b>VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË</b>	<b>4.00</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>45.60</b>

Tetovë, 11.12.2020

**KOMISIONI RECENSUES**

1. **Prof. Dr. Agim Shabani**, profesor ordinar në Programin Studimor të Kimisë – FSHMN, pranë Universitetit të Tetovës – kryetar

- 
2. **Prof. Dr. Shefket Dehari**, profesor inordinar në Programin Studimor të Kimisë – FSHMN, pranë Universitetit të Tetovës – anëtar

- 
3. **Doc. Dr. Zulxhevat Abdija**, docent në Programin Studimor të Kimisë – FSHMN, pranë Universitetit të Tetovës – anëtar
-

**Drejtuar:**

**Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakulteti të Shkencave Matematike - Natyrore**

**Tetovë, 11.12.2020**

## **R E F E R A T**

### **PËR ZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE DOCENT PËR LËNDËT MËSIMORE NË FUSHËN E INFORMATIKËS**

Në bazë të nenit 166 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të Statutit të Universitetit të Tetovës, në lidhje me konkursin e shpallur për zgjedhje më datën 28.11.2020 në Gazetën ditore Koha, Sloboden Peçat dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakulteti të Shkencave Matematike – Natyrore në mbledhjen e mbajtur më datë 07.12.2020 sjell: Vendimin (nr.15-2032/1) për formimin e komisionit recensues. Formohet komisioni për zgjedhje të një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e informatikës në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Jordan Shikoski – kryetar**
- 2. Prof. Dr. Eip Rufati - anëtar**
- 3. Prof.Dr. Valbon Ademi-anëtar**

Në konkursin e shpallur më datë 28.11.2020 Gazetën Koha, Sloboden Peçat dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, është paraqitur një kandidat:

**Doc.Dr. Shpend Ismalili** - i punësuar në marrëdhënie pune part time në Programin studimor Informatikë, Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore, në Universitetin e Tetovës.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati në fjalë, Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore i a paraqet këtë:

# RECENSION

Për zgjedhje të një mësimdhënës për lëndët mësimore në fushën e informatikës në programin studimor Informatikë, Fakulteti të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës.

## I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

### A. Shënime biografike të kandidatit

Nga autobiografia që i është bashkangjitur fletëparaqitjes shihet që kandidati Doc.Dr. Shpend Ismaili është i lindur më datë 23.10.1969 në Tetovë ku edhe e mbaroi shkollën fillore dhe të mesme.

Në vitin 1997 ka mbaruar studimet në Universitetin Politeknikë në Tiranë; Fakulteti i inxhinierisë elektrike, në degën e Elektronikës, seksioni Telekom me çrast edhe e fiton titullin inxhinier i elektronikës.

Në vitin 2011 mbaron studimet pasdiplomike dhe me sukses e mbron temën e magjistraturës: “Menaxhimi në distancë me agjentë mobil në Universitetin FON në Shkup, ku edhe e ka fituar titullin Magjistër i Teknologjisë së Komunikimit dhe të Informacionit

Në vitin 2018, përfundon studimet e doktoraturës në Akademin e Shkencave të Bullgarisë (BAS) në Sofje ku edhe e mbron temën e doktoraturës: “Zgjidhja e situatave konfliktuoze me modele të bazuar në agjent (ABM)” dhe ka fituar titullin profesional Doktor i Shkencave kompjuterike dhe të Informatikës

Në shkurt të vitit 2020 kandidati Shpend Ismaili zgjidhet në thirrjen Mësimore- Shkencore Docent në Universiteti ndërkombëtar të Strugës.

### B. Puna arsimore-pedagogjike

- Në vitin akademik 1998 - 2002 është punësuar profesor në shkollën e mesme profesionale komunale “Mosha Pijade” Tetovë, si profesor i lëndëve të elektroteknikës;
- Në vitin akademik 2007 - 2018 është punësuar profesor në shkollën e mesme profesionale komunale “Mosha Pijade” Tetovë, si profesor i lëndës së **programimit, sisteme digjitale**, dhe **mësim praktik** për drejtimin elektroteknik i teknikës kompjuterike dhe automatikës;
- Nga vitin 2010 është angazhuar si profesor part time në Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore, Programi studimor Matematikë – Informatikë, në Universitetit e Tetovës;

## II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

- **Mbajtja e mësimit (ligjërat dhe ushtrime)**
- Bazat e informatikës në programin studimor Informatikë (UT)
- Sinjalet dhe Sistemet në programin studimor Informatikë (UT)
- Bazat e Informatikës në programin studimor Inxhineria ekonomike (UT)
- Teknologji Informative në programin studimor Kontabilitet- Financa(UT)
- Hyrje në IT në programin studimor informatikë (UT)
- Përpunimi digjital i sinjaleve në programin studimor Informatikë(UT)
- Sistemet informative në turizëm e në programin studimor Turizëm(UT)
- Teknologji Informative në programin studimor Artet figurative (UT)
- Sistemet multimediale në programin studimor Informatikë (UT)
- Mikrokontrollorët dhe mikroprocesorët në programin studimor Informatikë (UT)
- Elektronika në programin studimor Informatikë (UT)
- Siguria dhe mirëmbajtja e rjetave në programin studimor Informatikë (UT)
- Hyrje në IT (Universiteti nderkombetar i Struges)

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i Universitetit), kandidati **Doc.Dr. Shpend Ismaili** ka realizuar gjithësej **83.85** pikë nga veprimtaria mësimore arsimore.

### III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidati është angazhuar vazhdimisht në hulumtime shkencore. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit përbëhet me publikimin e shumë punimeve në revistat shkencore e profesionale dhe referimet në konferencat ndërkombëtare si në vijim:

#### Punimet e publikuara

- **S. Ismaili**, L. Kamberi . Application of Software Agent in Next Generation Networks, International, Journal of Pure and Applied Mathematics, Volume 70, No 4 , 469-489, 2011
- L. Kamberi, Sh. Kameri, **Sh. Ismaili** An Evaluaton of the ICT Use by the Students of Tetovo Universities in Macedonia-International Journal of Digital Content Technology and Applications, ISSN 1975-9339, Volume 5, No 8, page 101-107 2011
- L. Kamberi, Sh. Kameri, **Sh. Ismaili**, Përdorimii TIK nga studentët e universiteteve në Tetovë për qëllime studimi, Takimi i Pestë Vjetor Ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca, Konferenca e Seksionit të Shkencave Inxhinierike dhe të Teknologjisë së Informacionit (TPVN-IASH-KSSHITI'2011), Prishtinë, Kosovë, 2011
- Dashmir Ibishi, Lazim Kamberi , Fetije Aduli, **Shpend Ismaili**, Estimation and testing for Logit Models by using R - Conference: 1ST International Conference of Natural Sciences ans Mathematics, At Tetovo, Macedonia Conference Paper · June 2017
- **Ismaili S.**, Fidanova S., Representation of Civilians and Police Officers by Generalized Nets for describing Software Agents in the Case of Protest, Advanced Computing in Industrial Mathematics, Studies of Computational Intelligence 728, K. Georgiev, I. Georgiev eds., Springer, ISBN 978-3-319-65529-1, 2018, pp. 71-78. SJR 0.187.
- **Ismaili S.** Fidanova S., Application of IFS for Conflict Resolution Modelling and Agent Based Simulation, J. Bioautomation, 2018, SJR 0.250,
- **Ismaili S.**, Fidanova S., Application of game theory and evolutionary algorithms in solving conflicts in social systems, 2018 J. Bioautomation, SJR 0.250
- **Ismaili S.**, Fidanova S., Modeling Software Agents Applying Intuitionistic Fuzzy Logic, Pceedings of the Bulgarian Academy of Sciences, IF 0.251

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhjen-rizgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale, kandidati **Doc.Dr. Shpend Ismaili** ka realizuar gjithsej **20.1** pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese

## V. FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcë e bashkëngjisim formularin për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore shkencore. Kandidati **Dr. Shpend Ismaili** ka gjithsej **103.95** pikë, edhe atë për: veprimtarinë mësimore-arsimore **83.85** pikë dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore **20.1** pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE	Pikët
VEPRIMTARIA MËSIMORE – ARSIMORE	83.85
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	20.1
<b>GJITHSEJ</b>	<b>103.95</b>

#### IV. PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Në bazë të konstatimeve të lartpërmendura, Komisioni recensues vlerëson se kandidati **Doc.Dr. Shpend Ismaili** i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhje në thirrjen mësimore shkencore **Docent**, duke u referuar në përvojën e deritanishme profesionale dhe pedagogjike. Gjate periudhës si mësimdhënës, kandidati ka pasur aktivitete të ndryshme dhe relevante nga lëmia e Shkencave të Informatikës dhe kompjuterike, kontinuitet në hulumtim dhe publikimin e punimeve në revista shkencore.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme, të aktiviteteve në veprimtaritë mësimore – arsimore dhe shkencore-hulumtuese, Komisioni Recensues konstaton se kandidati **Doc.Dr. Shpend Ismaili** në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit, ka gjithësejt **103.95** pikë dhe kështu ka arritur numrin e pikëve që duhet të realizohen për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore **Docent**.

Komisioni recensues i propozonë Këshillit Mësimor - Shkencor të Fakultetit Shkencave Matematike - Natyrore të Universitetit të Tetovës, që **Doc. dr. Shpend Ismaili** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **DOCENT** për lëndët mësimore në fushën e informatikës në programin studimor Informatikë në Fakultetit Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin e Tetovës.

#### **Komision recensues:**

**1. Prof. Dr. Jordan Shikoski - kryetar**

---

**2. Prof. Dr. Eip Rufati - anëtar**

---

**3. Prof. Dr. Valbon Ademi-anëtar**

---

**Tetovë, 11.12.2020**

## SHTOJCË

### E RECENSIONIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE MËSIMORE - SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE – PROFESIONALE

**Kandidati: Doc. Dr. Shpend Ismaili**

#### I. VEPRIMTARIA ARSIMORE

Lenda	praktik 0.03		teori 0.04		Java 15
	orë*	pikë*javë			
Bazat e Informatikes	9	4.05	0	0	
Sinjale dhe sisteme	12	5.4	0	0	
Bazat e informatikes kompjuterike	9	4.05	0	0	
Bazat e Informatikes	2	0.9	2	1.2	
Sinjale dhe sisteme	8	3.6	0	0	
Bazat e informatikes kompjuterike	9	4.05	0	0	
Bazat e Informatikes	2	0.9	2	1.2	
Sinjale dhe sisteme	8	3.6	0	0	
Informatika per ekonomist	2	0.9	2	1.2	
Teknologjia e informacionit	6	2.7	0	0	
Sinjale dhe sisteme	6	2.7	3	1.8	
Hyrje ne IT	3	1.35	0	0	
Perpunim digjital i sinjalit	3	1.35	3	1.8	
Sistemet multimediale	3	1.35	0	0	
e-biznesi	2	0.9	2	1.2	
Siguria dhe mirembajtja e rjetave	3	1.35	0	0	
perpunimi digjital i sinjalit	3	1.35	3	1.8	
Sistemet informative ne turizem	2	0.9	3	1.8	
elektronika	3	1.35	0	0	
mikroprocesoret dhe mikrokopntrolloret	3	1.35	0	0	
Informatika ne arte	2	0.9	3	1.8	
Sistemet informative ne turizem	2	0.9	3	1.8	
elektronika	3	1.35	0	0	
mikroprocesoret dhe mikrokopntrolloret	3	1.35	0	0	2018-2019



Siguria dhe mirembajtja e rjetave	3	1.35	3	1.8	
Sistemet informative ne turizem	2	0.9	3	1.8	
elektronika	3	1.35	0	0	2018-2019
mikroprocesoret dhe mikrokontrolloret	3	1.35	0	0	2019-2020
Siguria dhe mirembajtja e rjetave	3	1.35	3	1.8	
elektronika	3	1.35	0	0	
Sistemet informative ne turizem	2	0.9	3	1.8	
Menaxhimi i sistemeve informative	2	0.9	2	1.2	
Hyjre në IT (Univerisiteti nderkombetar Strugë)	2	0.9	2	0.9	
<b>Total</b>	<b>131</b>	<b>58.95</b>	<b>42</b>	<b>24.9</b>	<b>83.85</b>

## II. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

1.	<b>S. Ismaili</b> , L. Kamberi. Application of Software Agent in Next Generation Networks, International, Journal of Pure and Applied Mathematics, Volume 70, No 4 , 469-489, 2011	$3 \times 0.9 = 2.7$
2	L. Kamberi, Sh. Kameri, <b>Sh. Ismaili</b> An Evaluaton of the ICT Use by the Students of Tetovo Universities in Macedonia-International Journal of Digital Content Technology and Applications, ISSN 1975-9339, Volume 5, No 8, page 101-107 2011	$3 \times 0.8 = 2.4$
3	L. Kamberi, Sh. Kameri, <b>Sh. Ismaili</b> , Përdorimi i TIK nga studentët e universiteteve në Tetovë për qëllime studimi, Takimi i Pestë Vjetor Ndërkombëtar i Institutit Alb-Shkenca, Konferenca e Seksionit të Shkencave Inxhinierike dhe të Teknologjisë së Informacionit (TPVN-IASH-KSSHITI'2011), Prishtinë, Kosovë, 2011	$3 \times 0.8 = 2.4$
4	Dashmir Ibishi, Lazim Kamberi , Fetije Aduli, <b>Shpend Ismaili</b> , Estimation and testing for Logit Models by using R - Conference: 1ST International Conference of Natural Sciences ans Mathematics, At Tetovo, Macedonia Conference Paper · June 2017	$3 \times 0.6 = 1.8$
5	<b>Ismaili Sh.</b> , Fidanova S., Representation of Civilians and Police Officers by Generalized Nets for describing Software Agents in the Case of Protest, Advanced Computing in Industrial Mathematics, Studies of	$3 \times 0.9 = 5.4$

	Computational Intelligence 728, K. Georgiev, I. Georgiev eds., Springer, ISBN 978-3-319-65529-1, 2018, pp. 71-78. SJR 0.187	
6	<b>Ismaili Sh.</b> Fidanova S., Application of IFS for Conflict Resolution Modelling and Agent Based Simulation, J. Bioautomation, 2018, SJR 0.250	3x0.9=2.7
7	<b>Ismaili Sh.</b> , Fidanova S., Application of game theory and evolutionary algorithms in solving conflicts in social systems, 2018 J. Bioautomation, SJR 0.250	3x0.9=2.7
8	<b>Ismaili Sh.</b> , Fidanova S., Modeling Software Agents Applying Intuitionistic Fuzzy Logic, Preceedings of the Bulgarian Academy of Sciences, IF 0.251	3x0.9=2.7
		20.1

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE – ARSIMORE</b>	<b>83.85</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>20.1</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>103.95</b>

**Komision recensues:**

**1. Prof. Dr. Jordan Shikoski - kryetar**

---

**2. Prof. Dr. Eip Rufati - anëtar**

---

**3. Prof. Dr. Valbon Ademi-anëtar**

---

**Tetovë, 11.12.2020**

# UNIVERSITETI I TETOVËS

**Drejtuar:**

**Këshilli Mësimor- Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore**

**Tetovë, 11. 12. 2020**

Në bazë të neni 170, të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore- shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të Statutit të Universitetit të Tetovës, si dhe në bazë të procesverbalit (nr.15-2022/1) në mbledhjen e mbajtur më datë 04.12.2020 të Këshillit profesional të programit studimor Informatikë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në lidhje me konkursin për zgjedhje të shpallur me datën 28.11.2020 në gazetata ditore “Koha” dhe “Slloboden Peçat” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshillit Mësimor-Shkencor në mbledhjen e mbajtur më datë 07.12.2020 sjell: Vendimin (nr. 15-2033/1) për formimin e komisionit recensues. Formohet komisioni për zgjedhje të një asistent për lëndët mësimore në fushën e informatikës në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Florinda Imeri – kryetar**
- 2. Doc. Dr. Agon Memeti - anëtar**
- 3. Prof. Dr. Halim Halimi - anëtar**

Në konkursin e shpallur më date 28.11.2020 në gazetata ditore “Koha” dhe “Slloboden Peçat” dhe në Ueb faqen e Universitetit të Tetovës, është paraqitur një kandidat:

**Mr. sc. Vjollca Shemshi** - e angazhuar në kontratë ( Part – Time) në Programin studimor Informatikë, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, në Universitetin e Tetovës.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatja në fjalë, Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, e paraqetë këtë:

## **REFERAT**

Për zgjedhje e një asistent për lëndët mësimore në fushën e informatikës, pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës

### **I. Shënime biografike të kandidatës Vjollca Shemshi**

Vjollca Shemshi u lind në 29.11.1989 në Xhepçisht. Shkollën fillore e kreu në SH.F. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Xhepçisht, në periudhën 1996-2004, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Sh.M.K. Gjimnazi “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë gjatë periudhës 2004-2008. Studimet universitare i kreu në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në Programin studimor Informatikë në periudhën 2008-2012, ku fiton titullin Inxhinier i diplomuar i informatikës, me notë mesatare **9.15**, dhe gjithashtu vlerësohet si një ndër studentët më të dalluar të gjeneratës.

Vjollca Shemshi si studente e dalluar me notë mesatare të lartë fiton bursën studentore e ofruar nga MASH që nga viti i dytë i studimeve deri në përfundimin e studimeve.

Në vitin e dytë të studimeve Universiteti i Tetovës, kandidaten Vjollca Shemshi e liroi nga pagesa semestrale për shkak të mesatares së lartë dhe vlerësimit si student i dalluar.

Më 05 tetor 2013, Vjollca Shemshi mbaron studimet e ciklit të parë në Universitetin e Tetovës, me temë “Visual Basic në Access 2010” dhe fiton titullin Inxhinier i diplomuar i informatikës.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, angazhohet si asistent part-time në Programin studimor Informatikë.

Nga vitit 2013 e vazhdim, asistent part-time në Universitetin e Tetovës, në Programin studimor Informatikë.

Më 25 qershor 2016, Vjollca Shemshi mbaron studimet e ciklit të dytë në Universitetin e Tetovës me notë mesatare **9.50**, me temë të magistraturës “Disa aspekte praktike dhe

aplikative në sistemet për mësim elektronik e-learning, krahasimi ndërmjet sistemeve Blackboard dhe Moodle”, dhe fiton titullin **Magjistër i Informatikës**.

Aktualisht vijon studimet në ciklin e tretë, në Universitetin “Kirili dhe Metodi”, në Shkup, në Fakultetin e Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompjuterike, në drejtimin Informatikë, ku vazhdon hulumtimet në sferën e identifikimit elektronik, rreziqet e mundshme dhe sigurinë e sistemeve elektronike bashkëkohore, mjetet dhe teknologjitë e implementimit si dhe metodat dhe teknikat që përdoren në ditët e sodit për siguri më të lartë të të dhënave.

## **II. Përvoja profesionale**

Vjollca Shemshi në periudhën prej nëntor 2014 deri në qershor 2016 ka qenë e angazhuar edhe në Qendrën e Provimeve Shtetërore, si bashkëpunëtor në sektorin e informatikës, dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ka qenë e përfshirë në procesin e provimeve të maturës shtetërore.

Nga muaj shkurt 2020 është e angazhuar në Ndërmarrjen Publike, Radiodifuzioni Nacional Shkup, si ndihmës i udhëheqësit, në Sektorin për Zhvillim dhe Hulumtim, në Departamentin e IT-së. Në periudhën që ka qenë e angazhuar në këtë departament, ka realizuar një numër të madh të aktiviteteve, ndër më të rëndësishmet janë: Menaxhimi i stafit në sektorin e IT, zhvillimi dhe mirëmbajtja i të gjitha llojeve të programeve që përdor NRD (kontabiliteti, arkiva, moduli i burimeve njerëzore etj.), anëtare e ekipit të projektit për implementimin e strategjisë kombëtare Broadband në Maqedonia e Veriut, hartëzimi i të gjitha përdoruesve të mundshëm të institucioneve publike për internet me fibra optik dhe Wi-Fi, zbatimi dhe menaxhimi i platformës Gis (nga ESRI), anëtare e grupit për implementimin e standardeve të cilësisë ISO (9001:2015).

Në mënyrë direkt ka qenë e përfshirë në projektin Broadband, ku në qershor 2020 ka marrë edhe trajnime të posaçme për përdorimin e platformës GIS nga kompania Intelligent Network Solution (INS) ku më pas është çertifikuar për përfundimin e suksesshëm të trajnimit.

Gjithashtu në tetor 2020 ka qenë pjesë e trajnimit për implementimin e standardeve të cilësisë ISO (9001:2015) ku me sukses përfundoi trajnimin dhe kaloi testin për ISO 9001:2015 Internal Auditor.

Në gusht të vitit 2019, Byroja për Zhvillim e Arsimit në Shkup kandidaten Vjollca Shemshi e angazhoi si instruktore për të realizuar trajnim për të gjithë mësimdhënësit e shkollave fillore në tërë Maqedoninë e Veriut për implementimin e kurrikulës (programit mësimor) nacional të informatikës, si dhe realizimin e një programi mësimor ditor.

Në janar të vitit 2020, Vjollca Shemshi u angazhua si instruktore nga kompania IFES Shkup, për të realizuar trajnim për ndërgjegjësimin e higjienës kibernetike, për të gjithë anëtarët e komisionit zgjedhor të zgjedhjeve të realizuara në korrik të vitit 2020, në tërë Maqedoninë e Veriut, ku si tema kyçe kanë qenë: Mbrojtja e informacionit personal / publik, parandalimi i sulmeve Phishing, siguria e llogarive personale, politika e fjalëkalimeve personale dhe shumë tema të tjera.

Gjuha shqipe është gjuha amtare, megjithatë zotëron edhe gjuhën maqedonase, gjuhën angleze. Ka aftësi të mira në sferën e programimit, ku ndër të tjera mund të theksohen, njohje e mirë e gjuhës programore C# (konsollë, windows dhe web aplikacionet), gjuhët programore C++, PHP, njohuri të mira në HTML, CSS, Wordpress, përpunim multimedial.

Ka njohuri edhe në dizajnimin dhe implementimin e databazave ( SQL Server, MySQL), njohje të mirë të sistemit operativ LINUX, paketës Office etj. Poashtu, kandidatja posedon njohuri edhe në Matlab, Javascript, Multisim, GIS (ArcMap , ArcCatalog) njohje të mirë të inxhinierisë softuerike, veçanërisht në dizajnimin e metodave më efikase dhe efektive për modelim të sistemeve kompjuterike etj.

Nga viti 2013 deri në 2020 angazhohet si asistente në lëndët:

- Qarqe Logjike I dhe II, FSHMN, Programi studimor Informatikë
- Hyrje në Informatikë, FSHMN, Programi studimor Matematikë
- Teknologji Informative, Fakulteti Ekonomik
- Internet, FSHMN, Programi studimor Informatikë
- Sistemet Inteligjente, FSHMN, Programi studimor Informatikë
- Hyrje në sistemet e informacionit, FSHMN, Programi studimor Informatikë
- Analiza dhe dizajnimi i sistemeve të informacionit, FSHMN, Programi studimor Informatikë
- Multimedia dhe webdizajn , Fakulteti Juridik, drejtimi Gazetari
- Statistikë Mjekësore me Informatikë, FSHM, drejtimi Infermieri.

### III. Publikimet shkencore

Kandidatja Mr.sc. Vjollca Shemshi ka publikuar punime shkencore si vijon:

- **Vjollca Ismaili**, Fisnik Dalipi, Florim Idrizi, Qebir Shemshi “A study on Learners’s Percepation of Moodle and Blackboard for Blended Learning in a Macedonian University” 1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics, 16-17 June, 2017, University of Tetovo, Tetovo
- **Vjollca Shemshi**, Florim Idrizi, Qebir Shemshi “Dark Web and its Impact” Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 3 | No. 5-6, 2018 dhe në 2st International Conference of Natural Sciences and Mathematics, May, 2018, University of Tetovo, Tetovo.
- **Vjollca Shemshi**, Florim Idrizi, Qebir Shemshi “Risks of Electronik Identity in Education, By using Two Protocols: Openid Connect And Saml Protocols”, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 4 | No. 7-8, 2019 dhe në 3rd International Conference of Natural Sciences and Mathematics, 15-17 May, 2019, University of Tetovo, Tetovo

#### **IV. Përfundim dhe propozim**

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në konkursin e shpallur, kandidatja i plotëson kushtet ligjore edhe profesionale sipas nenit 170 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018)

Duke pasur parasysh vlerësimin e përgjithshëm të punës arsimore, kërkimore – shkencore, publikimin punimeve shkencore e profesionale dhe referimet në konferencat ndërkombëtare dhe përvojës në punën arsimore, notën mesatare gjatë studimeve të ciklit të parë **9.15** dhe ciklit të dytë **9.50**.

Komisioni recenzues ka nderin dhe respektin ti propozojë Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore që kandidatja **Vjollca Shemshi** të zgjidhet në thirrjen Mësimore - Shkencore **ASISTENT** për lëndët mësimore në fushën e informatikës.

Komision recenzues:

1. **Prof. Dr. Florinda Imeri** – kryetar

2. **Doc. Dr. Agon Memeti** – anëtar

3. **Prof. Dr. Halim Halimi** – anëtar

Tetovë, 11.12.2020



## UNIVERSITETI I TETOVËS

### Këshilli Mësimor- Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore

Në bazë të nenit 170, të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore- shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, si dhe në bazë të procesverbalit 15-2022/1 në mbledhjen e mbajtur më datë 04.12.2020, të Këshillit profesional të Programit studimor Informatikë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në lidhje me konkursin për zgjedhje-rizgjedhje të shpallur me datën 28.11.2020 në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden pečat”, si dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshillit Mësimor - Shkencor në mbledhjen e mbajtur më datë 7 Dhjetor 2020, sjell Vendim me nr. 15-2034/1 për formimin e komisionit recensues. Formohet komisioni për zgjedhje-rizgjedhje të një bashkëpunëtori në thirrje Asistent për lëndët mësimore në fushën e Ekonomisë:

1. **Prof. Dr. Alifeta SELIMI, Profesor ordinar - kryetar,**
2. **Prof. Dr. Brikend AZIRI, Profesor inordinar - anëtar,**
3. **Prof. Dr. Florim IDRIZI, Profesor inordinar - anëtar.**

Në konkursin e shpallur më date 28.11.2020 në gazetën “Koha”, “Sloboden pečat” dhe në Ueb faqen e Universitetit të Tetovës, është paraqitur **Mr.sc. Liridon Ismaili**, si i vetmi kandidat. Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati në fjalë, Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, e paraqet këtë:

#### **R A P O R T R E C E N S U E S**

për zgjedhje të një bashkëpunëtori në thirrjen Asistent, për lëndët mësimore në fushën e Ekonomisë, në Fakultetin e Shkencave Matematike – Natyrore, të Universitetit të Tetovës.

#### **1. Të dhënat biografike dhe ngritja profesionale e kandidatit**

**Liridon Ismaili** është i lindur në 09.12.1990 në Novi Knezhevac të Republikës së Serbisë. Shkollën fillore e kreu në SH.F. “Vëllezërit Milladinovci” në Strugë, në periudhë prej 1997 deri

në vitin 2005, ndërsa shkollën e mesme e kreu në SH.M.K. Gjinnazi “ Dr. Ibrahim Temo ” në Strugë gjatë periudhës 2005-2009. Studimet universitare i kreu në vitin 2017 pranë Universitetit të Tetovës, në Fakultetin e Ekonomik, Programi studimor Ekonomi dhe biznes me mesatare prej 8,65 ku fiton titullin *Ekonomist i diplomuar, drejtimi Ekonomi dhe Biznes*.

Në vitin akademik 2018/2019 në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tetovës mbron me sukses temën e magjistraturës “ *Strategjitë e bizneseve në rajonin e Pollogut* ”, gjegjësisht me mesatare prej 9,44 dhe fiton gradën shkencore *Magjistër i shkencave të Ekonomisë në fushën e menaxhmentit*.

Nga viti akademik 2019/2020 vijon të ndjek studimet e Ciklit të tretë, në Shkollën e doktoratës të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit “Kirili dhe Metodij”, në Shkup.

Nga viti 2016 deri në vitin 2018, kandidati *Liridon Ismaili* ka qenë i angazhuar në Drejtorinë e Shoqërisë aksionare „Posta e Maqedonisë,, në Shkup. Në këtë institucion ka qenë i ngarkuar me detyrime në vendin e punës Udhëheqës kontabiliteti në Sektorin për punë Ekonomike dhe financiare pranë Drejtorisë të SH.A. „Posta e Maqedonisë,, - Shkup.

Kandidati nga viti 2018 në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut është realizues në vendin e punës bashkëpunëtor për analizë të kushteve për zhvillim të PPP dhe Investimeve, në Departamentin e Partneritetit Publiko Privat dhe Investimeve, në Sektorin e politikave ekonomike, reformave strukturale dhe investimeve.

Në vitin 2019 nën organizimin e qeverisë së Maqedonisë së veriut, kandidati mori pjesë në samitet B2B, të organizuara mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe republikës së Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Federatës Ruse.

Nga viti akademik 2019/2020 dhe në vijim, Liridon Ismaili është i angazhuar partajm, si Bashkëpunëtor në Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore, në lëndët e shkencave ekonomike. Në fakt, kandidati nën mentorim të profesorëve eminent, ka asistuar në lëndët ekonomike si: Bazat e menaxhmentit, Etika në biznes dhe Planifikimi dhe menaxhimi i biznesit.

Kandidati ka ndjek trajnime të avancuara të Microsoft Windows, Microsoft Word, Microsoft Excel, Internet Explorer dhe protokolle të rrjetave TCP/IP, POP 3, HTML, UDP. Ai gjithashtu i është nënshtruar trajnimit në „distançë,, mbi Barazinë gjinore- niveli i avancuar,

i organizuar nga Ministria për shoqëri Informative dhe Administratë, e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## 2. Publikimet shkencore

Punimet shkencore të kandidatit *Mr.sc. Liridon Ismaili* janë si më poshtë:

1. *Valon Ameti, Liridon Ismaili* „Marketing Strategies Among Small And Medium Sized Companies In The Polog Region”, **Economic Vision**, International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism. **Vol.7, No.13/14 (2020)**
2. *Liridon Ismaili*, ‘‘Strategjitë e bizneseve të Rajonit të Pollogut’’, Punimi i magjistraturës.

Komisioni gjatë vlerësimit të punimeve shkencore të sipër përmendura arriti në përfundim si më poshtë:

1. Komisioni në fjalë konstaton se punimi parë ka të bëjë me strategjitë e marketingut tek ndërmarrjet e mesme dhe të vogla të rajonit të Pollogut, autorët në këtë punim përmes analizës së situatës së kompanive përkatëse, të cilat merren me aktivitete të ndryshme afariste, detektojnë problemet me të cilat ndeshen këta kompani. Në fakt, pamundësia e përshtatjes së amalgamat të marketingut miks, kundrejt nevojave të konsumatorëve nxjerr në pah fillimisht mungesën e planifikimit strategjik që sjellë si pasojë pozicionin jo konkurrues të kompanive të rajonit të Pollogut. Në përfundim të punimit bëhet edhe valorizimi i gjetjeve të punimit në kontekst të sugjerimeve me qëllim të eliminimit të mangësive që janë hasur si prezentë në menaxhimin kompanive.
2. Ndërsa sa i përket Punimit shkencor i cili ka të bëjë me Strategjitë e bizneseve të kompanive të rajonit të Pollogut, komisioni gjithashtu konstaton se ky punim në vete ngërthen të dhëna të cilat janë transferuar në informacione mbi Strategjitë që hartojnë bizneset të rajonit të Pollogut. Gjegjësisht, ky punim prek atë që mund të trajtohet si domosdoshmëri e afarizmit bashkëkohor, pra vendimmarrja afatgjate e cila duhet të jetë e përfshirë në dimensionin menaxhimit strategjik të bizneseve në fjalë.

### 3. Përfundim dhe propozim

Bazuar në dokumentacionin që ka dorëzuar kandidati në konkursin e shpallur, Komisioni konstaton se i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore që parashihen në nenin 166 dhe 170 të Ligjit për Arsim të Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare nr. 82/2018). Gjegjësisht, Komisioni gjithashtu jep mendim pozitiv për të gjitha realizimet e kandidatit dhe se të njëjtat janë në përputhshmëri me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për zgjedhje në thirrje mësimore shkencore të parapara me ligj.

Si përfundimin, komisioni në këtë përbërje ka nderin që Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore ti propozoj që kandidati **Mr.sc. Liridon Ismaili** të zgjidhet në thirrjen Mësimore - Shkencore **Asistent** për lëndët mësimore në fushën e Ekonomisë, në të gjitha Programet studimore të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore.

*Tetovë, 2020*

*Komisioni recensues:*

**1. Prof.Dr. Alifeta SELIMI** \_\_\_\_\_

**2. Prof.Dr. Brikend AZIRI** \_\_\_\_\_

**3. Prof.Dr. Florim IDRIZI** \_\_\_\_\_

**Deri te:**

### **Këshilli Mësimor- Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore**

Në bazë të neni 170, të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të Statutit të Universitetit të Tetovës, si dhe në bazë të procesverbalit (nr.15-2013/1) në mbledhjen e mbajtur më datë 03.12.2020 të Këshillit profesional të programit studimor Matematikë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në lidhje me konkursin për zgjedhje të shpallur me datën 28.11.2020 në gazetën “Koha”, “Slloboden pečat” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshillit Mësimor-Shkencor në mbledhjen e mbajtur më datë 07.12.2020 sjell: Vendimin (nr. 15-2030/1) për formimin e komisionit recensues.

Formohet komisioni për zgjedhje të dy asistentëve për lëndët mësimore në fushën e Matematikës:

- 1. Prof. Dr. Flamure Sadiki - Profesor inordinar - Kryetar**
- 2. Prof. Dr. Alit Ibraimi - Profesor inordinar – anëtar**
- 3. Prof. Dr. Lazim Kamberi - Profesor inordinar – anëtar**

Në konkursin e shpallur më datë 28.11.2020 në gazetën “Koha”, ” Slloboden pečat” dhe në Ueb faqen e Universitetit të Tetovës, janë paraqitur dy kandidat:

- **Mr. sc. Yldrita Salihi** - e angazhuar në kontratë (Part – Time) në Programin studimor Matematike, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, në Universitetin e Tetovës.
- **Mr. sc. Merita Bajrami** - e angazhuar në kontratë (Part – Time) në Programin studimor Matematike, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, në Universitetin e Tetovës.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët në fjalë, Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, i paraqetë këtë:

**REFERAT**

Për zgjedhjen e dy asistentëve për lëndët mësimore në fushën e Matematikës, pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës

**Mr. sc. Ylldrita Salihi**

### **I. Shënime biografike të kandidatës Mr. sc. Ylldrita Salihi**

Ylldrita Salihi u lind në 12.02.1992 në Tetovë. Shkollën fillore e kreu në SH.F.K. “Liria” në Tetovë, në periudhën 2003-2007, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Sh.M.K. Gjinnazi “Kiril Pejçinoviç”, drejtimi Matematikë-Natyror, kombinimi A, në Tetovë, gjatë periudhës 2007-2011.

Studimet universitare i kreu në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në Programin studimor Matematikë, në periudhën 2011-2015, ku fiton titullin Profesoreshë e Matematikës, me notë mesatare 9.87. Si studente e dalluar, me notë mesatare të lartë, fiton bursën studentore që nga viti i dytë i studimeve.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, angazhohet si asistente part-time në Programin studimor Matematikë dhe fiton bursë si studente ekselente studentore për vazhdimin falas të studimeve të ciklit të dytë.

Prej vitit 2015 e deri në ditët e sodit ajo vazhdon si asistente part-time në Universitetin e Tetovës, në katedrën e Matematikës.

Më 07 Shtator 2017, Ylldrita Salihi mbaron studimet e ciklit të dytë në Universitetin e Tetovës me notë mesatare 9.8, me temë të magjistraturës “Interpretimi i strukturave ternare në planet afine dhe projektive” dhe fiton titullin Magjistre e Matematikës.

Në po të njëjtin vit, 20 Tetor 2017, fillon dhe vijon studimet në ciklin e tretë, në Universitetin “Kirili dhe Metodij”, në Shkup, në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore, në drejtimin Teoria Matematikës dhe Zbatime, ku vazhdon hulumtimet në sferën e Matematikës së zbatuar, më konkretisht, Zgjidhja numerike e disa sistemeve jolineare diferenciale me derivate fraksional. Studime në të cilat kandidatja, ka përfunduar provimet, konferencat dhe seminarët e parapara, dhe vazhdon përgaditjen për mbrojtjen e temës së doktoraturës.

### **II. Përvoja profesionale**

Në vitin 2015, pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve, Ylldrita Salihi, angazhohet si asistente part-time, në katedrën e Matematikës, në Universitetin e Tetovës.

Njëkohësisht, në po atë vit, ajo fillon me punë si profesoreshë e Matematikës, në SHMK të Mjekësisë, “Nikolla Shtejn”- Tetovë, përvojë e cila zgjat një vit shkollor. Në vitin 2016 vazhdon përvojën profesionale për dy vite shkollore, si arsimtare e matematikës në shkollën fillore “Istikball”, në Tetovë. Poashtu brenda kësaj periudhe vazhdon të punojë si profesoreshë e matematikës në SHMK, Gjinnazin, Kiril Pejçinoviç, Tetovë, deri në vitin 2019.

Përvojës profesionale i bashkangjitet edhe angazhimi part-time në Universitetin Ballkanik, Shkup, gjatë viteve 2018-2020, në të cilin Ylldrita Salihi, ishte ligjëruese (në gjuhën angleze) në lëndet, Matematika I, Matematika II dhe Matematika Diskrete.

Gjuha shqipe është gjuha amtare, megjithatë fletë rrjedhshëm edhe gjuhën maqedone, gjuhën angleze dhe ka njohuri edhe në gjuhën gjermane. Ka aftësi të mira në sferën e Teknologjisë Informatike, njeh mirë programet Microsoft Office, GeoGebra, Python, Corel Draw, dhe në ato të programimit të metodave numerike për zgjidhje të prolemeve të ndryshme në matematikë, ku ndër të tjera mund të theksohen, njohje e mirë e progamieve LaTeX, Wolfram Mathematica dhe Matlab.

Ylldrita Salihi është pjesmarëse në Konferencën e parë, të dytë dhe të tretë, të organizuar nga Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, Universiteti i Tetovës, në vitet 2017, 2018, 2019, përkatësisht.

### III. Publikimet shkencore

Kandidatja Mr.sc. Ylldrita Seferi / Salihi ka publikuar punimet shkencore si vijon:

1. I. Haliti, L. Kamberi, **Ylldrita Seferi**, *General Birth-Death Process and Some of Their EM Algorithms*, XXV-th Traditional International Scientific Conference , Natural & Mathematical Science, Vol. 5, No. 3, 2015 (30-37).

2. F. Sadiki, A. Ibraimi, **Ylldrita Seferi**, K. Rasimi, *Ternary Rings and Projective Planes*, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 2, No. 4, 2017 (172-187).

3. **Ylldrita Seferi**, Gj. Markoski, A. Gjurcinovski, *Comparison of Different Numerical Methods For Fractional Differential Equations*, Matematicki Bilten, 42(LXVIII) No.2, 2018 (61-74).

4. **Ylldrita Seferi**, Gj. Markoski, A. Gjurcinovski, *Comparative analysis of different numerical methods for fractional Lorenz system*, Conference Proceedings CSPM 2018, September 27th - 30th, Ohrid, Macedonia.

5. F. Sadiki, **Ylldrita Seferi**, A. Ibraimi, *Relation Between Associative Ternary Operations and Neutral Sequences*, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 3, No. 5-6, 2018 (222-231).

6. K. Rasimi, **Ylldrita Seferi**, A. Ibraimi, F. Sadiki, *Skew  $n$ -Binormal Operators*, International Journal of Mathematical Analysis Vol. 13, no. 11, 2019, (513 – 517).

7. K. Rasimi, **Ylldrita Seferi**, A. Ibraimi, F. Sadiki, *Numerical-Analytical Solution of Nonlinear Fractional-Order Lorenz's System*, Applied Mathematical Sciences, Vol. 13, no. 13, 2019 (595 – 606).

8. F. Sadiki, A. Ibraimi, F. Sadiki, **Ylldrita Seferi**, *Finite Projective Planes and Hamming Codes*, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 4, No. 7-8, 2019 (210-216).

9. **Ylldrita Seferi**, Gj. Markoski, A. Gjurginovski, *Numerical Solution and Chaotic Dynamic of Fractional-Order Lorenz and Chen System*, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 4, No. 7-8, 2019 (210-216).

10. **Ylldrita Seferi**, F. Sadiki, A. Ibraimi, F. Imeri, *Introduce of Post Algebra to Ternary and Real Semigroups*, Fifth International Mediterranean Natural Sciences, Health Sciences and Engineering Congress, Budapest, Hungary September 10-12, 2019 (249-257).

11. **Ylldrita Seferi**, Gj. Markoski, A. Gjurginovski, *Comparison of Two Numerical Methods For Fractional-Order Lorenz System*, Matematicki Bilten, 2020.

12. **Ylldrita Seferi**, F. Sadiki, A. Ibraimi, K. Rasimi, *Solving Initial-Value Differential Problems Using Numerical Multistep Methods*, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 5, 2020.

#### **Tekstet (Përmbledhjet) e botuara:**

1. Alit Ibraimi, Flamure Sadiki, Krutan Rasimi, Florinda Imeri, **Ylldrita Seferi**, *Strukturat Diskrete I*, Alma Grafika, Shkup, 2018.

2. Flamure Sadiki, Alit Ibraimi, Krutan Rasimi, **Ylldrita Seferi**, *Përmbledhje Detyrash nga Transformimet Gjeometrike*, Universteti i Tetovës, Tetovë, 2018.



## **Mr. sc. Merita Bajrami**

### **I. Shënime biografike të kandidatës Mr. sc. Merita Bajrami**

Merita Bajrami u lind në 02.10.1992 në Tetovë. Shkollën fillore e kreu në SH.F.K. “Istikball” në Tetovë, në periudhën 2003-2007, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Sh.M.K. Gjinnazi “Kiril Pejçinoviç”, në Tetovë, gjatë periudhës 2007-2011.

Studimet universitare i kreu në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në Programin studimor Matematikë, në periudhën 2011-2015, ku fiton titullin Profesoreshë e Matematikës, me notë mesatare 8.55.

Prej vitit 2017 e deri sot ajo është e angazhuar si asistente part-time në Universitetin e Tetovës, në katedrën e Matematikës.

Në vitin 2016, Merita Bajrami fillon studimet e ciklit të dytë në Universitetin e Tetovës, të cilat i mbaron në vitin 2018, me notë mesatare 9.4, me temë të magjistraturës “Disa klasë të gjysmëgrupeve “ dhe fiton titullin Magjistre e Matematikës.

Në vitin 2019, fillon dhe vijon studimet në ciklin e tretë, në Universitetin “Kirili dhe Metodij”, në Shkup, në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore, në drejtimin Teoria Matematikës dhe Zbatime, ku vazhdon hulumtimet në sferën e Algjebres.

### **II. Përvoja profesionale**

Nga 15.09.2017, Merita Bajrami, angazhohet si asistente part-time, në katedrën e Matematikës, Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore, në Universitetin e Tetovës.

Në vitin 2016, ajo fillon me punë si profesoreshë e Matematikës, në SHMK , “8 Shtatori”-Tetovë, përvojë e cila zgjat një vit shkollor. Në vitin 2017 vazhdon përvojën profesionale për një vit shkollor, si arsimtare e matematikës në shkollën fillore “Rilindja”, në fshatin Sellcë, në Tetovë.

Gjuha shqipe është gjuha amtare, megjithatë fletë rrjedhshëm edhe gjuhën maqedone, gjuhën angleze dhe ka njohuri edhe në gjuhën gjermane. Ka aftësi të mira në sferën e Teknologjisë Informatike, ajo njih dhe shfrytëzon programe të tilla si Microsoft Office, GeoGebra, LaTeX, dhe gjuhë programore, si C++.

Merita Bajrami është pjesmarëse në Konferencën e parë, të dyte dhe të tretë, të organizuar nga Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, Universiteti i Tetovës, në vitet 2017, 2018, 2019, përkatësisht.

### **III. Publikimet shkencore**

1. R. Ramani, L. Kamberi, **M. Azemi**, " Decompositon of an exponential semigroup into its archimedean components " , ICNSM2017 , University of Tetovo
2. R. Ramani, L. Kamberi, **M. Azemi**, "Special classes of regular semigroups " , Vienë 2018.
3. **M. Azemi**, R. Ramani, "Inverse semigroups as a special class of regular semigroups", ICNSM2018.
4. **M. Azemi**, R. Ramani, "Green's relations in semigroups", ICNSM2019, University of Tetovo.
5. R. Ramani, **M. Bajrami**, B. Shaini, "Some Properties of Semigroups". British Journal of Science 105, August 2019, Vol. 18 (1).
6. **M. Bajrami**, R. Ramani "Completely prime ideals of semigroups". University of Tetovo, 2020.
7. Sh.Hajrulla, L.Bezati, **M. Bajrami**, F. Hoxha, "Linearization of water wave breaking equation. Mathematical description and approximation", 2020. Istanbul Mathematics Conference Istanbul Meeting.

#### **IV. Përfundim dhe propozim**

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në konkursin e shpallur për zgjedhjen e dy asistentëve për lëndët mësimore në fushën e Matematikës, kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore edhe profesionale sipas nenit 170 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018)

Duke pasur parasysh vlerësimin e përgjithshëm të punës arsimore, kërkimore – shkencore, publikimin e punimeve shkencore e profesionale dhe referimet në konferencat ndërkombëtare si dhe përvojës në punën arsimore, Komisioni Recensues konstaton se Mr.sc. Ylldrita Seferi dhe Mr.sc. Merita Bajrami i plotësojnë të gjitha kushtet për t'u zgjedhur në thirrjen që kanë konkurruar. Andaj Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike- Natyrore, që kandidatët Mr.sc. Ylldrita Seferi dhe Mr.sc. Merita Bajrami të zgjidhen në thirrjen mësimore shkencore **ASISTENT** - për lëndët mësimore në fushën e Matematikës.

#### **Komisioni recensues:**

**1. Prof. Dr. Flamure Sadiki - Profesor inordinar - Kryetar**

---

**2. Prof. Dr. Alit Ibraimi - Profesor inordinar – anëtar**

---

**3. Prof. Dr. Lazim Kamberi - Profesor inordinar – anëtar**

---

Tetovë, 11.12.2020

# **UNIVERSITETI I TETOVËS**

**Drejtuar:**

**Këshilli Mësimor- Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore**

Në bazë të neni 170, të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore- shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të Statutit të Universitetit të Tetovës, si dhe në bazë të procesverbalit (nr.15-2022/1) në mbledhjen e mbajtur më datë 04.12.2020 të Këshillit profesional të programit studimor Informatikë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në lidhje me konkursin për zgjedhje të shpallur me datën 03.12.2020 në gazetata ditore “Koha” dhe “Sllloboden Peçat” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshillit Mësimor-Shkencor në mbledhjen e mbajtur më datë 11.12.2020 sjell: Vendimin (nr.15-2044/1) për formimin e komisionit recensues. Formohet komisioni për zgjedhje të një asistent për lëndët mësimore në fushën e informatikës në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Florim Idrizi – kryetar**
- 2. Prof. Dr. Florinda Imeri - anëtar**
- 3. Prof. Dr. Halim Halimi – anëtar**

Në konkursin e shpallur më date 03.12.2020 në gazetata ditore “Koha” dhe “Sllloboden Peçat” dhe në Ueb faqen e Universitetit të Tetovës, është paraqitur një kandidat:

**Mr. Sc. Nexhibe Sejfuli - Ramadani** - e angazhuar në kontratë ( Part – Time) në Programin studimor Informatikë, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, në Universitetin e Tetovës.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati në fjalë, Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, e paraqetë këtë:

# REFERAT

Për zgjedhje e një asistent për lëndët mësimore në fushën e informatikës, pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës

## I. Shënime biografike të kandidatës Nexhibe Sejfuli - Ramadani

Kandidatja Nexhibe Sejfuli – Ramadani u lind më 04.12.1990 në Tetovë. Nga viti 2018 ajo vazhdon studimet në ciklin e tretë në Universitetin “Kirili dhe Metodij” në Shkup, në Fakultetin e Elektroteknikës dhe Teknologjisë Informative në drejtimin Elektroteknikë dhe Teknologji Informative në fushën e Cyber Security.

Studimet e ciklit të dytë i kreu me datë 25.01.2016 në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Matematike – Natyrore, në Programin e Informatikës, me tezë “Analiza, modifikimi dhe krahasimi i sensorëve që përdoren te paisjet mobile” dhe me notë mesatare 9.56, me cka edhe fitoi titullin **Magjistër i Informatikës**, me 60 kredi të fituara.

Studimet universitare i kreu më 16.09.2013 në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në Programin studimor të Informatikës, me temë diplome “Sistemi Online për menaxhim hotelerik” ku fiton titullin **Inxhinier i diplomuar i informatikës**, me 240 kredi të fituara dhe me notë mesatare 9.72.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, angazhohet si asistente part-time në Programin studimor të Informatikës. Nga viti 2013 ajo vazhdon si asistente part-time në Universitetin e Tetovës, në katedrën e Informatikës.

## II. Përvoja profesionale

Kandidatja Nexhibe Sejfuli – Ramadani ka qenë anëtare e komisionit organizativ në “2<sup>nd</sup> International Conference of Natural Science and Mathematics” në Universitetin e Tetovës, Prill 2018 – Qershor 2018 dhe “3<sup>rd</sup> International Conference of Natural Science and Mathematics” në Universitetin e Tetovës, Prill 2019 – Maj 2019.

Pjesëmarrëse në realizimin e aktivitetit, Ditët e hapura të UT, Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore, 2017/2018 dhe pjesëmarrëse në realizimin e aktivitetit, Ditët e hapura të UT, Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore, 2018/2019

Gjithashtu gjatë periudhës Janar 2020 – Mars 2020, ka qenë pjesë e projektit Research in the NATO Science for Peace Multi-Year Project SPS G5633, ANTI-DRONES – Innovative concept to Detect, Recognize and Track “Killer Drones”.

Nexhibe Sejfuli – Ramadani në periudhën 17-18 Shtator 2020 në Shkup do merr pjesë në “Avancimi i kompetencave të mësimeve në mësim ONLINE”

Gjuha shqipe është gjuha amtare, megjithatë fletë rrjedhshëm edhe gjuhën maqedone dhe gjuhën angleze. Ka njohuri në dizajnimin dhe implementimin e bazave të të dhënave (SQL Server, MySQL, MS Access), ka aftësi të mira në sferën e programimit, njohje të mirë të gjuhës programore C# (konsollë, windows dhe web aplikacionet), gjuhët programore C++, PHP, Python, njohuri të mira në HTML, CSS, Java Script, Wordpress dhe përpunim multimedial. Gjithashtu njohje të mirë të sistemit operativ LINUX, paketës Office.

Nga viti 2013- 2020 angazhohet si asistente në lëndët:

- Bazat e të dhënave, FSHMN, drejtimi Informatikë
- Qarqe Logjike I, FSHMN, drejtimi Informatikë
- Programim në C++, FSHMN, drejtimi Matematikë
- Interneti, FSHMN, drejtimi Informatikë
- Ueb Dizajn, Fakulteti Juridik, drejtimi Gazetari
- Sisteme Multimediale, FSHMN, drejtimi Informatikë
- Statistikë Mjekësore me Informatikë, FSHM, drejtimi Infermieri
- Statistikë Mjekësore me Informatikë, FSHM, drejtimi Mjekësi e Përgjithëshme
- Informatika për Psikologët, Fakulteti Filozofik, drejtimi Psikologji
- Teknologji Informative, Fakulteti i Administrimit të Biznesi, drejtimi Administratë Biznesi

### III. Publikimet shkencore

Kandidatja **Mr.sc. Nexhibe Sejfuli - Ramadani** ka publikuar punime shkencore si vijon:

- Florinda Imeri, Agon Memeti, **Nexhibe Sejfuli-Ramadani**, and Hana Saliu: “The Impact of PPT Presentations in Teaching and Learning Process, Case Study: University of Tetova,” Journal of Natural Sciences and Mathematics of the University of Tetova, 2019.
- **Nexhibe Sejfuli-Ramadani**, Florim Idrizi, and Florinda Imeri: “The Influence of the Dark Web,” Journal of Natural Sciences and Mathematics of the University of Tetova, 2019.
- **Nexhibe Sejfuli-Ramadani**, Erenis Ramadani, and Verda Misimi: “Blockchain: General Overview of the Architecture, Security and Reliability,” Journal of Natural Sciences and Mathematics of the University of Tetova, 2018.
- Erenis Ramadani, Agon Memeti, Florinda Imeri, **Nexhibe Sejfuli-Ramadani**, and Florim Idrizi: “Social Media based App Organizing Daily Events,” Sixth Mediterranean Conference on Embedded Computing (MECO – 2017), Bar, Montenegro, 2017.
- **Nexhibe Sejfuli-Ramadani**, Verda Misimi, Erenis Ramadani, and Florim Idrizi: “The Role and the Impact of Digital Certificate and Digital Signature in Improving Security During Data Transmission,” European Journal of Sustainable Development Research, Vol. 1, Issue 1, CNR Goup, Istanbul, Turkey, 2016.
- **Nexhibe Sejfuli-Ramadani**, Florim Idrizi and Erenis Ramadani: “Analysis and Comparison of the Sensors used in Mobile Devices,” International Journal on Information Technologies and Security, ISSN 1313-8251, No. 1, 2016.

#### **IV. Përfundim dhe propozim**

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në konkursin e shpallur, kandidati i plotëson kushtet ligjore edhe profesionale sipas nenit 170 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018)

Duke pasur parasysh vlerësimin e përgjithshëm të punës arsimore, kërkimore – shkencore, publikimin punimeve shkencore e profesionale dhe referimet në konferencat ndërkombëtare dhe përvojës në punën arsimore, notën mesatare gjatë studimeve të ciklit të parë **9.72** dhe ciklit të dytë **9.56**.

Komisioni recenzues ka nderin dhe respektin ti propozojë Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore që kandidatja **Nexhibe Sejfuli-Ramadani** të zgjidhet në thirjen Mësimore - Shkencore **ASISTENT** për lëndët mësimore në fushën e informatikës.

Komision recensues:

**1. Prof. Dr. Florim Idrizi** – kryetar

**2. Prof. Dr. Florinda Imeri** – anëtar

**3. Prof. Dr. Halim Halimi** – anëtar

Tetovë, dhjetor 2020



**Deri te:**

**Këshilli Mësimor- Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore**

Në bazë të neni 170, të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore- shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të Statutit të Universitetit të Tetovës, si dhe në bazë të procesverbalit(nr.15-2013) në mbledhjen e mbajtur më datë 03.12.2020të Këshillit profesional të programit studimor Matematikë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në lidhje me konkursin për zgjedhje të shpallur me datën 03.12.2020në gazetën “Koha”, “Sllloboden peçat” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshillit Mësimor-Shkencor në mbledhjen e mbajtur më datë 11.12.2020sjell: Vendimin (nr. 15-2043/1) për formimin e komisionit recensues. Formohet komisioni për zgjedhje të një asistenti për lëndët mësimore në fushën e Matematikës:

- 1. Prof. Dr. Lazim Kamberi –Profesor inordinar -kryetar**
- 2. Prof. Dr. Alit Ibraimi -Profesor inordinar -anëtar**
- 3. Prof. Dr. Flamure Sadiki- Profesor inordinar -anëtar**

Në konkursin e shpallur më datë 03.12.2020 në gazetën “Koha”, “Sllloboden peçat” dhe në Ueb faqen e Universitetit të Tetovës, janë paraqitur dy kandidat:

- **Mr. sc. Miranda Xhaferi** - e angazhuar në kontratë (Part – Time) në Programin studimor Matematikë, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, në Universitetin eTetovës.
- **Mr. sc. Ferzije Lleshi** - e angazhuar në kontratë (Part – Time) në Programin studimor Matematikë, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, në Universitetin eTetovës.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët në fjalë, Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, i paraqetë këtë:

## REFERAT

Për zgjedhjen e një asistenti për lëndët mësimore në fushën e Matematikës, pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin e Tetovës.

**Mr. sc.Miranda Xhaferi**

### **I. Shënime biografike të kandidatës Mr. sc. Miranda Xhaferi**

Miranda Xhaferi u lind më 26.02.1992 në Tetovë. Shkollën fillore e kreu në Sh.F.K. “Luigj Gurakuqi” në Zhelinë, në vitin 2006, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Sh.M.K. Gjinnazi “Kiril Pejçinoviç”, drejtimi matematik-natyor, në Tetovë gjatë periudhës 2006-2010.

Në periudhën 2010-2014 studioi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Programin studimor Matematikë në Universitetin e Tetovës, ku diplomoi me mesatare 9.35 dhe fitoi titullin **Profesor i diplomuar i Matematikës**.

Miranda Xhaferi si studente e dalluar me notë mesatare të lartë fiton bursën studentore që nga viti i dytë i studimeve.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, angazhohet si bashkëpunore e jashtme (asistent part-time) në Programin studimor Matematikë. Prej vitit 2016 e deri në ditët e sodit ajo vazhdon si asistente part-time në Universitetin e Tetovës, në katedrën e Matematikës dhe Fizikës.

Në vitin 2019, Miranda Xhaferi mbaron studimet e ciklit të dytë në Universitetin e Tetovës me notë mesatare **9.60**, me temë të magjistraturës “Zgjerime të teoremës Fuglede-Putnam”, dhe fiton titullin **Magjistër i Matematikës**.

Aktualisht vijon studimet në ciklin e tretë, në Universitetin “Kirili dhe Metodij”, në Shkup, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në drejtimin Matematikë e zbatuar.

## II. Përvoja profesionale

Në vitin 2016, pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve, Miranda Xhaferi si studente e dalluar, angazhohet si asistent në Universitetin e Tetovës në katedrën e Matematikës dhe Fizikës. Gjatë periudhës që ka punuar si asistente, kandidatja Miranda Xhaferi ka mbajtur ushtrime në katedrën e Matematikës edhe atë në lëndët:

- Analiza Matematike 1A
- Analiza Matematike 1B
- Bashkësitë dhe Logjika Matematike
- Algjebra Lineare I

Ndërsa në katedrën e Fizikës ushtrime në lëndët:

- Analiza Matematike I
- Analiza Matematike II
- Algjebër Lineare
- Metodot Matematikore në Fizikë I

Njëkohësisht, kandidatja Miranda Xhaferi nga viti 2016 është angazhuar si arsimtare e matematikës në Sh.F.K. “ Istikball” - Tetovë.

Në vitin 2018, kandidatja jep provimin profesional për mësimdhënës në lëndën e matematikës dhe pajiset me certifikatë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në vitin 2019, kandidatja ka qenë e angazhuar si kordinatore e garave rajonale të matematikës të organizuara nga Unioni i Matematikanëve të Maqedonisë.

Miranda Xhaferi poashtu ka punuar në qendrën private për mësimin e gjuhëve të huaja dhe trajnimeve profesionale në sfera të ndryshme, “Vision Academy”, Tetovë, si trajnuese në lëndën e Matematikës gjatë vitit 2015.

Kandidatja Miranda Xhaferi flet rrjedhshëm gjuhën angleze dhe atë maqedone, ndërsa gjuhët sllave i njih mjaftueshëm për shfrytëzim literature profesionale. Në aspektin e njohurive teknologjike ajo ka njohuri të mjaftueshme në gjuhët programore C++ dhe LaTeX si dhe programin Mathematica dhe paketën Office.

### III. Veprimtaria nga interesi më i gjërë

Gjatë angazhimit si part-time në Universitetin e Tetovës, kandidatja nga viti 2017-2019 ka marrë pjesë në organizimin e aktiviteteve Ditët e Hapura në Universitetin e Tetovës.

Kandidatja Miranda Xhaferi ka qenë edhe pjesë e trajnimeve të ndryshme gjatë veprimtarisë së saj mësimore, ndër të cilat do të përmendim disa më me rëndësi si pjesëmarrje në trajnimet:

- “ *Critical thinking and problem-solving*”, i organizuar nga British Council, në periudhën kohore 13-15 Janar 2020, Tetovë.

- “ *Micro:bit basics course* “ , British Council, Janar, 2020.

- “ *Application of coding in the teaching practice and practical examples and activities*“, 21st Century Schools programme, British Council, Shkurt 2020.

- “ *Inclusive Education* ”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës- Byroja për zhvillimin e arsimit, Tetovë, 2019.

- “ *Realization of teaching using ICT for learning*”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës- Byroja për zhvillimin e arsimit, Gusht, 2020.

- “ *Learning Management System Platforms*”, Training for National Platforms for Distance Learning, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shtator, 2020.

- “ *The New Normal Education post COVID-19* “, Conference delegate, T4.Education, Maj, 2020.

- “ *Edmodo Basics Course*”, Edmodo Training, Qershor, 2020.

### IV. Publikimet shkencore dhe pjesëmarrja në konferenca

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidatja është marrë vazhdimisht me hulumtime shkencore në fushën e matematikës dhe informatikës, si dhe në fushën e edukimit dhe arsimit. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatës përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare si dhe pjesëmarrje në konferenca. Mr.sc. Miranda Xhaferi ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme si:

- 4<sup>th</sup> ICFPH of University of Tetovo, Education in societies with cultural diversity, October 2016, Tetovo, North Macedonia.
- 5<sup>th</sup> International Scientific Conference of the Faculty of Philosophy of University of Tetovo, Meeting point and cultural divergences in the Balkans , Oct 2017, Tetovo, North Macedonia.

- 1<sup>st</sup> International Conference of Natural Sciences and Mathematics of University of Tetovo, June 2017, Tetovo, North Macedonia.
- XIX International Scientific Conference, Knowledge in Practice, 14-16 December, 2018, Bansko, Bulgaria.
- 2<sup>nd</sup> International Conference of Natural Sciences and Mathematics of University of Tetovo, June 2018, Tetovo, North Macedonia.
- International Congress on Natural, Health Sciences and Technology, 3<sup>rd</sup> International Conference of Natural Sciences and Mathematics of University of Tetovo, 15-17 May, 2019, Tetovo, North Macedonia.

Kandidatja Mr.sc. Miranda Xhaferi ka publikuar punimet shkencore si vijon:

- Ibish Kadriu, Sermijete Xhaferi, **Miranda Xhaferi**, “ *Integrated interethnic education and development of intercultural skills*”, International Journal of Social and Human Sciences, Philosophica, Vol.4 / No. 7 / (2017),ISSN: 1857-9272, Tetovo, North Macedonia.
- Sermijete Xhaferi, Ibish Kadriu, **Miranda Xhaferi**, ”*Identity and cultural diversity*”, International Journal of Social and Human Sciences, Philosophica,Vol. 5 / No. 9 / (2018), ISSN: 1854-9272,Tetovo, North Macedonia.
- Alit Ibraimi, Flamure Sadiki, **Miranda Xhaferi**, “*Construction of latin squares from an affine plane of order n*”, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 2/ No. 4 / (2017), ISSN: 2545-4072, Tetovo, North Macedonia.
- Verda Misimi, **Miranda Xhaferi**, “*A survey: Internet of things (IOT)- Aplications. Benefits & Challenges*”, Knowledge, International Journal Scientific Papers , Vol.28 / No. 5 / (2018), ISSN: 2545-4439, Skopje, North Macedonia.
- **Miranda Xhaferi**, Alit Ibraimi, Flamure Sadiki, Krutan Rasimi, “*Relation between multialgebras and Boolean algebras with operator*”, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol.4 / No. 7-8 / (2019), ISSN: 2545-4072 , Tetovo, North Macedonia.

- Astrina Xhaferi, Florim Idrizi, **Miranda Xhaferi**, “ *Online Payment Systems for e-Banking and Blockchain Technology* ”, Economic Vision, International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism, Vol.7 / No. 13-14 / (2020), ISSN: 1857-9566, Tetovo, North Macedonia.

**Mr. sc. Ferzije Lleshi**

## **I. Shënime biografike të kandidatës Mr. sc. Ferzije Lleshi**

Ferzije Lleshi u lind më 11.10.1988 në Strugë. Shkollën e mesme e kreu në Sh.M.K. Gjymnazi “Ibraim Temo”, në Strugë gjatë periudhës 2003-2007.

Në periudhën 2007-2011 studioi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Programin studimor Matematikë në Universitetin e Tetovës, ku diplomoi me mesatare 9.80 dhe fitoi titullin **Profesor i diplomuar i Matematikës**.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, angazhohet si bashkëpunatore e jashtme (asistent part-time) në Programin studimor Matematikë. Prej vitit 2012 ajo vazhdon si asistente part-time në Universitetin e Tetovës, në katedrën e Matematikës.

Në vitin 2014, Ferzije Lleshi mbaron studimet e ciklit të dytë në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodij”, në Shkup, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore me notë mesatare **10.00**, dhe fiton titullin **Magjistër i Matematikës**.

Aktualisht vijon studimet në ciklin e tretë, në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodij”, në Shkup, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në drejtimin Matematikë e zbatuar.

## **II. Përvoja profesionale**

Në vitin 2012, pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve, Ferzije Lleshi si studente e dalluar, angazhohet si asistent në Universitetin e Tetovës në katedrën e Matematikës dhe Arkitekturës. Gjatë periudhës që ka punuar si asistente, kandidatja Ferzije Lleshi ka mbajtur ushtrime në lëndët:

- Matematika 1 dhe 2
- Analizë numerike
- Algjebër lineare 2

- Bazat e statistikës
- Hyrje në topologji
- Analiza komplekse
- Programim linear

Njëkohësisht, kandidatja Ferzije Lleshi nga viti 2011 është angazhuar si profesoreshë e matematikës në Sh.M.K. “Niko Nestor” - Strugë në të cilën shkollë nga viti 2017 është edhe kryetare e bordit drejtues.

Kandidatja Ferzije Lleshi flet rrjedhshëm gjuhën angleze dhe atë maqedone, ndërsa gjuhët sllave i njih mjaftueshëm për shfrytëzim literature profesionale. Në aspektin e njohurive teknologjike ajo ka një mjafueshëm gjuhët programore Html dhe LaTeX si dhe paketën Office.

### **III. Veprimtaria nga interesi më i gjërë**

Në CV-në e kandidates nuk hasëm të dhëna për veprimtarinë nga interesi më i gjërë.

### **IV. Publikimet shkencore dhe pjesëmarja në konferenca**

Kandidatja Mr.sc. Ferzije Lleshi ka publikuar një punim shkencor me të cilin ka marrë pjesë në 2<sup>nd</sup>International Conference of Natural Sciences and Mathematics of University of Tetovo, 2018.

- **Ferzije Lleshi**, Krutan Rasimi, Egzona Iseni, “*A note on the cluster sets of interpolating Blaschke products*”, *Jornal of Natural Sciences and Mathematics of UT*, 3 (5-6), pp. 196-202, ISSN 2671-3039, 2018.

## **V. Përfundim dhe propozim**

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në konkursin e shpallur, kandidati i plotëson kushtet ligjore edhe profesionale sipas nenit 170 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.82/2018).

Duke pasur parasysh vlerësimin e përgjithshëm të punës arsimore, kërkimore – shkencore, publikimin punimeve shkencore e profesionale dhe referimet në konferencat ndërkombëtare dhe përvojës në punën arsimore, Komisioni Recensues konstaton se Mr.sc. Miranda Xhaferi i plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhur në thirrjen që ka konkuruar. Andaj Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike- Natyrore, që kandidati **Mr.sc. Miranda Xhaferi** të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore **ASISTENT** - për lëndët mësimore në fushën e Matematikës.

### **Komisioni recensues:**

- 1. Prof. Dr. Lazim Kamberi - Profesor inordinar - Kryetar**

---

- 2. Prof. Dr. Alit Ibraimi - Profesor inordinar – anëtar**

---

- 3. Prof. Dr. Flamure Sadiki-Profesor inordinar – anëtar**

---

Tetovë, Dhjetor, 2020